



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE**

**PËR**

**ZGJEDHJET E KËSHILLIT STUDENTOR NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

**Miratur me Vendimin Nr.68, datë 21.12.2017  
të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,  
ndryshuar me Vendimin Nr. 20, datë 16.03.2018, të Senatit Akademik të Universitetit të  
Mjekësisë, Tiranë**

**Tiranë, 2018**

# **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

## **Neni 1 Objekti i rregullores**

Kjo rregullore përcakton rregullat për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe kushtet dhe afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, kriteret për hartimin e listës të zgjedhësve, procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve, procedurat për shqyrtimin e ankimimeve, si dhe rregullat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.


## **Neni 2 Baza ligjore**

Kjo rregullore mbështetet në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, neni 99, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i ndryshuar, nenet 80, 81 dhe 82, Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, e ndryshuar, neni 81, si dhe Statutin e Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.


## **Neni 3 Subjekti i rregullores**

1. Kjo rregullore i shtrin efektet e saj për zgjedhjet e Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe këshillave studentorë të fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Subjekt i saj janë studentët me kohë të plotë të të gjitha programeve të studimit të fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përkatësisht:
  - studentët e programeve të ciklit të parë Bachelor;
  - studentët e programeve të ciklit të dytë të integruar;
  - studentët e programeve të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”;
  - studentët e programeve të specializimeve afatgjata.
3. Çdo student ka të drejtën e zgjedhjes dhe të të zgjedhurit për përfaqësuesit e studentëve (kryetar dhe anëtar) në Këshillin Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe fakultetet e tij, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë rregullore dhe me bazën ligjore të përshkruar në nenin 2 të saj.

## **Neni 4 Parimet e përgjithshme**



1. Zgjedhjet për kryetar dhe anëtar të Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe fakultetet e tij, mbahen në mënyrë periodike, çdo 2 (dy) vjet.
2. Këshilli Studentor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (KSUMT), përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë, ku njëri prej tyre zgjidhet kryetar i KSUMT-së.
3. Këshilli Studentor i Fakultetit të Mjekësisë, UMT, përbëhet nga 9 (nëntë) përfaqësues të studentëve:
  - a) kryetari (zgjidhet nga të gjithë studentët e të gjitha programeve të studimit të Fakultetit të Mjekësisë);
  - b) 4 (katër) anëtarë zgjidhen nga programi i studimeve Mjekësi e Përgjithshme (zgjidhen nga të gjithë studentët e programit të studimit Mjekësi e Përgjithshme të Fakultetit të Mjekësisë);
  - c) 2 (dy) anëtarë zgjidhen nga programi i studimit Farmaci (zgjidhen nga të gjithë studentët e programit të studimit Farmaci të Fakultetit të Mjekësisë);
  - d) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimit Shëndet Publik (zgjidhet nga të gjithë studentët e programit të studimit Shëndet Publik të Fakultetit të Mjekësisë);
  - e) 1 (një) anëtar zgjidhet nga specializantët e programeve të studimit Specializime Afatgjata në Fushën e Mjekësisë (zgjidhet nga lista e të gjithë specializantëve të Fakultetit të Mjekësisë).
4. Këshilli Studentor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UMT, përbëhet nga 7 (shtatë) përfaqësues të studentëve:
  - a) kryetari (zgjidhet nga të gjithë studentët e të gjitha programeve të studimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike);
  - b) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimeve Infermieri e Përgjithshme (zgjidhen nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Infermieri e Përgjithshme);
  - c) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimit Teknikë Laboratori (zgjidhet nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Teknikë Laboratori);
  - d) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimit Logopedi (zgjidhet nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Logopedi);
  - e) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimit Teknikë Imazherie (zgjidhet nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Teknikë Imazherie);
  - f) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimit Mami (zgjidhet nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Mami);
  - g) 1 (një) anëtar zgjidhet nga programi i studimit Fizioterapi (zgjidhet nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Fizioterapi).
5. Këshilli Studentor i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, UMT, përbëhet nga 3 (tre) përfaqësues të studentëve:
  - a) kryetari (zgjidhet nga të gjithë studentët e të gjitha programeve të studimit të Fakultetit të Mjekësisë Dentare);
  - b) 2 (dy) anëtarë zgjidhen nga programi i studimit Stomatologji (zgjidhen nga të gjithë studentët e



programit të studimit të ciklit të dytë të integruar Stomatologji dhe ciklit të tretë specializime afatgjata në Fakultetin e Mjekësisë Dentare).

6. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë e të fshehtë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
7. Çdo votues ka të drejtën e një vote të vetme për secilën strukturë që zgjedh (pra, një votë për kryetarin e këshillit studentor të fakultetit në të cilin është student dhe një votë për anëtarët e këshillit studentor të fakultetit).
8. Çdo student i fakulteteve të UMT-së mund të vetëkandidohet për t'u përzgjedhur vetëm në njërin nga komisionet zgjedhore të parashikuara në këtë rregullore, për UMT-në ose fakultetin në të cilin studion.
9. Të drejtën për t'u zgjedhur si përfaqësues në këshillin studentor të fakultetit përkatës (kryetar ose anëtar) e ka çdo student që vetëkandidohet, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
10. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe të zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cenuar procesin mësimor. Shpallet i zgjedhur në pozicionin e kryetarit apo anëtarit të këshillit studentor të fakultetit përkatës kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që marrin pjesë në votim, me përjashtim të kandidatëve të vetëm (të cilët duhet të marrin 50%+1 të votave të vlefshme).
11. Çdo kandidat ka të drejtë të ketë vëzhguesit e tij në qendrën e votimit, në qendrën e numërimit të votave, në KZS-në e fakultetit përkatës, si dhe në KIZS. Listën me emrat e vëzhguesve kandidati e depoziton pranë KIZS-së 3 (tri) ditë pas aplikimit të tij si kandidat.
12. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për kryetar dhe anëtar të këshillit studentor të fakulteteve dhe KSUMT-së bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i UMT-së, në praninë e kandidatëve.

## **Neni 5**

### **Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve**

1. Periudha zgjedhore shpallet me vendim të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ndërsa data e zgjedhjeve shpallet me vendim të dekanëve përkatës të fakulteteve të UMT-së, brenda periudhës zgjedhore të shpallur nga rektori, duke marrë parasysh afatet e nevojshme për krijimin e komisioneve përkatëse dhe zhvillimin e fushatës zgjedhore.
2. Qendrat e votimit hapen në orën 9:00 dhe mbylLEN në orën 15:00. Askush nuk mund të votojë pasi komisionet e qendrave të votimit të fakulteteve të UMT-së marrin vendim për mbylljen e votimit, pasi janë siguruar për votimin e të gjithë studentëve që janë në radhë, në pritje të votimit, në orarin e mbylljes së votimit.



## **KREU II**

### **PËRGATITJA DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

#### **Neni 6**

#### **Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (KIZS)**

Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është organi përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor për Këshillin Studentor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i përbërë nga anëtarë, të cilët zgjedhin të mos kandidojnë për pozicionet e kryetarit dhe anëtarit të këshillave studentorë të fakulteteve dhe të Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

#### **Neni 7**

#### **Përbërja dhe funksionet e KIZS-së**

1. KIZS-ja në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarësh dhe 1 (një) sekretar pa të drejtë vote:
  - kryetari (i cili zgjidhet nga anëtarët);
  - 3 (tre) anëtarë nga Fakulteti i Mjekësisë;
  - 2 (dy) anëtarë nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
  - 2 (dy) anëtarë nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
  - sekretari, i cili përzgjidhet me short nga përfaqësuesit e zgjedhur nga secili fakultet për këtë pozicion. Shortin për këtë pozicion e organizon KIZS-ja, pas konstituimit dhe zgjedhjes së kryetarit.
  
2. Dekanatet e fakulteteve përzgjedhin me short dhe shpallin me vendim të dekanit anëtarët përfaqësues të KIZS-së dhe 1 (një) përfaqësues për pozicionin e sekretarit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga lista e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
  - a) Në mbledhjen e parë, KIZS-ja zgjedh kryetarin me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj. Rezultati i zgjedhjes publikohet nga KIZS-ja në të gjitha mjediset e universitetit.
  - b) Gjatë periudhës zgjedhore, KIZS-ja mbledhet jo më pak se 3 (tri) herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga 2 (dy) anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZS-së janë të hapura për çdo kandidat.
  - c) KIZS-ja i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve (50%+1). Vendimet e KIZS-së publikohen në mjediset e universitetit, jo më vonë se 24 orë pas vendimmarrjes.
  
3. KIZS-ja ka këto kompetenca:
  - a) nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor;
  - b) drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor;
  - c) përzgjedh me short anëtarët dhe sekretarin e komisioneve zgjedhore studentore të fakulteteve



të UMT-së, të cilët vetëkandidohen pranë KIZS-së;

- d) miraton vulën për KIZS-në, për KZS-të dhe KQV-të e fakulteteve përkatëse, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi;
  - g) regjistron kandidatët për kryetar dhe anëtar të këshillit studentor sipas fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
  - h) shpall rezultatin e zgjedhjeve për kryetar dhe anëtar të këshillit studentor sipas fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
  - i) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimimet që regjistrohen prej kandidatëve.
4. Mandati i anëtarit të KIZS-së ndërpritet në rastet kur:
- a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) jep dorëheqjen nga detyra;
  - c) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - d) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
  - e) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 (tri) mbledhje radhazi;
  - f) humbet statusin e studentit;
  - g) ndërron jetë.
5. Vendi i mbetur bosh në KIZS dhe komisionet zgjedhore studentore të fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, plotësohet me short nga dekanati përkatës brenda 24 orëve prej listave të studentëve të vetëkandiduar, të depozituara në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
6. Sekretari i KIZS-së përgatit materialet për çdo mbledhje të tij. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe, për çdo rast, jep shpjegime për çështjet që i kërkojnë. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset e vuloset nga sekretari. Sekretari i KIZS-së është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të komisionit. Vendimet e komisionit firmosen prej të gjithë anëtarëve dhe vulosen me vulën e KIZS-së. Çdo anëtar i KIZS-së, krahas nënshkrimit të tij, mund të deklarojë në vendim votën kundër. Kohëzgjatja e mandatit të KIZS-së të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është 2-vjeçare.

## **Neni 8**

### **Komisioni i Apelimit Studentor (KAS)**

1. KAS-i përbëhet prej 3 (tre) anëtarësh, 1 (një) anëtar për secilin fakultet, të cilët zgjedhin mes tyre kryetarin. Anëtarët e KAS-it nuk kanë të drejtë të kandidojnë për kryetar apo anëtar të këshillit studentor.
2. Dekanatet e fakulteteve përzgjedhin me short dhe shpallin me vendim të dekanit anëtarin përfaqësues të KAS-it jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga lista e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.



3. Në mbledhjen e parë, KAS-i zgjedh kryetarin, me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të tij. Rezultati i zgjedhjes publikohet nga KAS-i në mjediset e UMT-së.
4. Gjatë periudhës zgjedhore, KAS-i mblidhet vetëm për të marrë në shqyrtim kërkesat e drejtuara nga kandidatët. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KAS-it janë të hapura për çdo kandidat dhe çdo anëtar të KIZS-së së UMT-së, prania e të cilëve është e lejuar.
5. KAS-i i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij (50% + 1). Vendimet e Komisionit të Apelit publikohen në mjediset e universitetit, jo më vonë se 24 orë pas vendimmarrjes.
6. KAS-i ka këto kompetenca:
  - a) shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për çdo ankim për vendime të marra prej KIZS-së;
  - b) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimimet që regjistrohen prej kandidatëve;
  - c) dërgon për dajeni në KIZS vendimet e marra për ankesat që janë paraqitur pranë tij.
7. Vendimi i KAS mund të apelohe në Komisionin e Apelit (KA) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Vendimi i KA së UMT-së është i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm për tu zbatuar.<sup>1</sup>
8. Mandati i anëtarit të KAS-it ndërpritet në rastet kur:
  - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) jep dorëheqjen nga detyra;
  - c) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - d) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rendë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
  - e) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 (tri) mbledhje radhazi;
  - f) humbet statusin e studentit;
  - g) ndërron jetë.
9. Vendi i mbetur bosh në KAS plotësohet nga dekanati përkatës, brenda 24 orëve, prej listave të studentëve të vetëkandiduar, të depozituara në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.

### **Neni 9**

#### **Komisionet Zgjedhore Studentore (KZS)**

1. Vendimi për ngritjen e KZS-ve merret nga KIZS-ja jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga dita

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.20, datë 16.03.2018, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.



e formimit të saj.

2. Anëtarët e KZS-ve nuk kanë të drejtë të kandidojnë për kryetar apo anëtar të këshillit studentor.
3. Anëtarët e KZS-ve të fakulteteve të UMT-së do të zgjidhen me short nga KIZS-ja nga lista e studentëve të vetëkandiduar për këtë komision.
4. KZS-të në fakultetet e UMT-së përbëhen nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët në mbledhjen e parë pas konstituimit, zgjedhin mes tyre kryetarin dhe sekretarin me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë (50%+1 votë).
5. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZS-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe, për çdo rast, jep shpjegime për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZS-së. Vendimet firmosen prej gjithë anëtarëve të KZS-së. Ditën e votimit, vendimet e marra firmosen dhe vulosen nga KZS-ja me vulën e marrë nga KIZS-ja bashkë me materialet zgjedhore.
6. KZS-të i marrin vendimet me shumicë të thjeshtë (50%+1) të të gjithë anëtarëve të tyre.
7. KZS-të kanë këto kompetenca:
  - a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të fakultetit përkatës;
  - b) pas përfundimit të procesit të votimit, marrin në dorëzim kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të KQV-ve përkatëse dhe, më pas, fillojnë procesin e numërimit të votave, rezultatin e të cilave e pasqyrojnë në procesverbalet dhe tabelat përkatëse.
  - c) hartojnë tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit të KQV-ve përkatëse dhe shpallin, me vendim të veçantë, rezultatet e votimeve për anëtarët dhe kryetarin e këshillit studentor të fakultetit.
8. Mandati i anëtarit të KZS-së ndërpritet në rastet kur:
  - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
  - b) jep dorëheqjen nga detyra;
  - c) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rendë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
  - d) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 (tri) mbledhje radhazi;
  - e) humbet statusin e studentit;
  - f) ndërron jetë.
9. Vendi i mbetur bosh plotësohet me short nga KIZS-ja brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga lista e kandidatëve që janë vetëkandiduar në sekretarinë e komisionit.
10. Në ditën e zgjedhjeve, Komisioni Zgjedhor Studentor (KZS) do të ushtrojë funksionin e





Komisionit të Qendrës së Votimit.

## Neni 10

### Komisionet e qendrave të votimit

1. Vendimi për ngritjen e KQV-ve të fakulteteve të UMT-së merret nga KZS-ja përkatëse jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga dita e formimit të KZS-ve.
2. Anëtarët e KQV-ve nuk kanë të drejtë të kandidojnë për kryetar apo anëtar të këshillit studentor.
3. Anëtarët e KQV-ve të fakulteteve të UMT-së përbëhen nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët zgjidhen me short nga KZS-të përkatëse nga lista e studentëve të vetëkandiduar për këtë komision.
4. Në procedurat e para të ditës së votimit zgjidhet kryetari dhe sekretari me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të KQV-ve.
5. KQV-të kanë këto kompetenca:
  - a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të qendrës së votimit;
  - b) pas përfundimit të procesit të votimit, i dërgojnë kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore në KZS-në e fakultetit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.


## Neni 11

### Komisionet e qendrave të votimit në fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

1. Komisionet e qendrave të votimit në Fakultetin e Mjekësisë janë 5 (pesë), të strukturuar si më poshtë vijon:
  - a) Komisioni Zgjedhor Studentor (KZS), i cili ditën e zgjedhjeve do të ushtrojë funksionin e Komisionit të Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë – Mjekësi e Përgjithshme 1 (KZSFM-MP/1), ku anëtarë janë studentë të programit Mjekësi e Përgjithshme, të vitit të parë, të dytë dhe të tretë. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Mjekësi e Përgjithshme, të vitit të parë, të dytë dhe të tretë.
  - b) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë – Mjekësi e Përgjithshme 2 (KQVFM-MP/2), ku anëtarë janë studentë të programit Mjekësi e Përgjithshme, të vitit të katërt, të pestë dhe të gjashtë. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Mjekësi e Përgjithshme, të vitit të katërt, të pestë dhe të gjashtë.
  - c) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë – Farmaci (KQVFM-FA), ku anëtarë janë studentë të programit Farmaci. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Farmaci.
  - d) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë – Shëndet Publik (KQVFM-SHP), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit Shëndet Publik. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Shëndet Publik.



- e) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë - Specializime Afatgjata (KQVFM-SA), ku anëtarë janë studentë të programeve të studimit specializime afatgjata. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programeve të studimit specializime afatgjata.
2. Komisionet e qendrave të votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë 6 (gjashtë), të strukturuar si më poshtë vijon:
- a) Komisioni Zgjedhor Studentor (KZS), i cili ditën e zgjedhjeve do të ushtrojë funksionin e Komisionit të Qendrës së Votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (KZSFHMT/1), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Infermeri e Përgjithshme. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Infermeri e Përgjithshme.
  - b) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (KQVFSHMT/2), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Teknikë Laboratori. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Teknikë Laboratori.
  - c) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (KQVFSHMT/3), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Logopedi. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Logopedi.
  - d) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (KQVFSHMT/4), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Teknikë Imazherie. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Teknikë Imazherie.
  - e) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (KQVFSHMT/5), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Mami. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Mami.
  - f) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (KQVFSHMT/6), ku anëtarë janë studentë të ciklit të parë dhe të dytë të programit të studimit Fizioterapi. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e programit Fizioterapi.
3. Komisionet e qendrave të votimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë 3 (tri), të strukturuar si më poshtë vijon:
- a) Komisioni Zgjedhor Studentor (KZS), i cili ditën e zgjedhjeve do të ushtrojë funksionin e Komisionit të Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare (KZSFMD/1), ku anëtarë janë studentë të vitit të parë dhe të dytë të programit të studimit Stomatologji. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e vitit të parë dhe vitit të dytë të programit Stomatologji.
  - b) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare (KQVFMD/2), ku anëtarë janë studentë të vitit të tretë dhe të katërt të programit të studimit Stomatologji. Në këtë qendër votojnë të gjithë studentët e vitit të tretë dhe vitit të katërt të programit Stomatologji.
  - c) Komisioni i Qendrës së Votimit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare (KQVFMD/3), ku anëtarë janë studentë të vitit të pestë të programit të studimit Stomatologji dhe studentë të specializimit afatgjatë në Kirurgji OMF. Në këtë qendër votimi votojnë të gjithë studentët e vitit të pestë të programit Stomatologji dhe të gjithë studentët e specializimit afatgjatë në



Kirurgji OMF.


**Neni 12**  
**Qendrat e votimit**

1. Votimi kryhet në qendrat e votimit, ku votohen konkretisht në:
  - a) 5 (pesë) qendra votimi te Fakulteti i Mjekësisë;
  - b) 6 (gjashtë) qendra votimi te Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.
  - c) 3 (tri) qendra votimi te Fakultetit i Mjekësisë Dentare.
2. Në të gjitha qendrat e votimit të mësipërme votohet për anëtarë dhe kryetar të këshillit studentor të fakultetit përkatës.

**KREU III**  
**ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE**

**Neni 13**  
**Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve**

1. Kanë të drejtën e zgjedhjes studentët me kohë të plotë të të gjitha cikleve dhe programeve të studimit në fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Kanë të drejtën për të kandiduar të gjithë studentët me kohë të plotë të ciklit të parë, të ciklit të dvtë, të programeve të integruara dhe specializimeve afatgjata në fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.
3. Kandidatët për kryetar të këshillit studentor të fakultetit nuk mund të kandidojnë edhe për anëtarë të këshillit studentor të fakultetit dhe anasjellas.
4. Organi përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve është sekretaria mësimore e fakultetit përkatës, duke ndarë më vete listat sipas secilit program studimi dhe ciklin e tretë të studimeve të specializimeve afatgjata dhe sipas viteve.
5. Procedura për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë vijon:
  - a) Lista paraprake e studentëve hartohet nga sekretaria mësimore jo më vonë se 3 (tri) ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve.
  - b) Lista paraprake afishohet në mjediset e fakulteteve përkatëse.
  - c) Gjatë një periudhe deri në 5 (pesë) ditë pas shpalljes së listës paraprake, sekretaria mësimore pranon kërkesat për korrigjime.
  - d) Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria mësimore realizon korrigjimin e kërkuar brenda 24 orësh.



- e) Pas përfundimit të afatit për korrigjimin e listës, sekretaria mësimore harton listën përfundimtare, e cila miratohet nga dekani i fakultetit përkatës.
6. Lista e zgjedhësve afishohet në mjediset e fakultetit përkatës dhe një kopje e listës i dërgohet KIZS-së. Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe prej dekanit dhe e vulosur me vulën e fakultetit përkatës.

**KREU IV**  
**REGJISTRIMI I KANDIDATËVE PËR KRYETAR DHE ANËTAR TË KËSHILLIT**  
**STUDENTOR TË FAKULTETIT DHE FUSHATA ZGJEDHORE**

**Neni 14**  
**Regjistrimi kandidatëve**

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për kryetar dhe anëtar të këshillit studentor të fakultetit bëhet nga Komisioni Zgjedhor Institucional Studentor. Data për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve shpallet prej KIZS-së pas ditës së konstituimit të tij dhe zgjat 10 ditë kalendarike.
2. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

**Neni 15**  
**Dokumentacioni për kandidim**

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZS dhe përmban:
  - a) kërkesën për kandidim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim për kryetar apo anëtar të këshillit studentor të fakultetit;
  - b) fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
  - c) vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë pranë fakultetit përkatës;
  - d) listën e notave të fituara deri në momentin e kandidimit (nota mesatare aritmetike duhet të jetë mbi 8 (tetë)).
2. Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZS-ja, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listat e kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të këshillit studentor të fakulteteve përkatëse, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Listat përcillen në komisionet zgjedhore studentore të fakulteteve dhe shpallen publikisht nga këto të fundit menjëherë në mjediset e fakultetit përkatës.

**Neni 16**  
**Kohezgjatja e mandateve**

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe fakulteteve të tij zgjidhen për një mandat 2-vjeçar.



**Neni 17**  
**Fushata zgjedhore**

1. Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së kandidatëve të regjistruar.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë lloj fushate zgjedhore.
3. Administratori dhe administrata e fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, krijojnë kushte të përshtatshme dhe të barabarta për të gjithë kandidatët për të zhvilluar aktivitetin e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, pa cenuar procesin mësimor, si dhe përcakton mjediset dhe plotëson kërkesat e komisioneve të ngritura në fakultetin përkatës, me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve.

**KREU V**  
**PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE E DOKUMENTACIONIT PËR ZGJEDHJET**

**Neni 18**

**Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votave**

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
  - a) Selia e KIZS-së dhe KAS-it vendoset në godinën e Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Selitë e KZS-ve dhe KQV-ve vendosen në godinat përkatëse të fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të cilat shërbejnë edhe si vendet e votimit dhe numërimit të votave.

**Neni 19**

**Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave**


1. *Shfuqizohet.*<sup>2</sup>
2. KZF-ja e fakulteteve përkatëse të UMT-së, nën vëzhgimin e KZS-së, pas numërimit të votave plotësojnë tabelën zgjedhore dhe ia përcjellin atë KIZS-së.<sup>3</sup>
3. KIZS-ja shpall rezultatet e zgjedhjeve sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe, pas kalimit të afateve për ankimimin, shpall fituesit e zgjedhjeve.

**Neni 20**

**Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor**

<sup>2</sup> Shfuqizuar me Vendimin nr.20, datë 16.03.2018, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

<sup>3</sup> Ndryshuar me Vendimin nr.20, datë 16.03.2018, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.



1. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listave përkatëse, plus 1% e tyre.
2. Forma e fletës së votimit përgatitet prej KIZS-së.
3. Fleta e kandidatit për kryetar të këshillit studentor të fakultetit përkatës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ka të njëjtën ngjyrë për të gjitha qendrat e votimit.
4. Fletët për anëtarë të këshillit studentor të fakultetit përkatës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kanë ngjyra të ndryshme nga fleta e votimit për kryetarin.
5. Fleta duhet të jetë me specifika të tilla që të mos lejojnë manipulimin e tyre; janë prej letre format A4, me ngjyrë dhe trashësi që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj.
6. Fletët e votimit përmbajnë informacionet e mëposhtme:
  - a) Në to vendosen emrat e kandidatëve për kryetar ose emrat e kandidatëve për anëtarë të këshillit studentor të fakultetit përkatës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
  - b) Të gjitha fletët e votimit vulosen me vulën e KIZS-së përpara se të dërgohen në KZS-të e fakulteteve.

#### **Neni 21**

#### **Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZS-ja në KZS-të e fakulteteve të UMT-së**

1. Një ditë përpara datës së zgjedhjeve, KIZS-ja dërgon në KZS-të e fakulteteve të UMT-së kutinë me materialet zgjedhore, si më poshtë vijon:
  - a) fletët e votimit të vulosura me vulën e KIZS-së në përputhje me numrin e votuesve +1%;
  - b) listën e zgjedhësve;
  - c) vulën e KZS-së dhe vulat e KQV-ve të secilit fakultet;
  - d) procesverbalet e qendrës së votimit, ku bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
  - e) zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të dëmtuara"
  - f) zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura";
  - g) zarfin në të cilin është shënuar "Zarf i procesverbalit të vulosjes".
2. Përveç kutisë me materialet zgjedhore, në KZS dërgohen edhe kutitë e votimit, tabelat për rezultatin e zgjedhjeve; dhomat e fshehta dhe vulat me kodet e sigurisë.
3. KZS-ja shpërndan bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e votimit në KQV-të e ngritura në fakultetin përkatës. Ky proces bëhet ditën e zgjedhjeve, përpara fillimit të procesit të votimit, si dhe pasqyrohet në procesverbalin përkaës.

### **KREU VI VOTIMI**

#### **Neni 22**

#### **Veprimet paraprake për hapjen e qendrës së votimit**



1. Në çdo qendër votimi votohet në dy kuti votimi, kutia e votimit për kryetar të këshillit studentor të fakultetit dhe kutia e votimit për anëtarë të këshillit studentor të fakultetit përkatës të UMT-së, të cilat janë të dallueshme nga njëra-tjetra.
2. KZS-të dhe KQV-të, nën drejtimin e kryetarit, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit, kryejnë keto detyra:
  - a) vendosin tryezat, karriget, dhomat e fshehta dhe kutitë e votimit, në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, si edhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;
  - b) afishojnë udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
  - c) kontrollojnë të gjitha materialet e marra në dorëzim;
  - d) u tregojnë të pranishmëve kutitë e votimit të zbrazëta;
  - e) mbyllin kutitë e votimit dhe i shkruajnë këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së.
3. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar "Zarf i procesverbalit të vulosjes", i cili futet në kutinë e votimit. Anëtarët e KZS-ve dhe KQV-ve marrin vendim për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

### **Neni 23**

#### **Procedurat e votimit**

1. Votimi për kryetar dhe anëtarë të këshillit studentor të fakultetit bëhet në të njëjtën ditë, në datën e caktuar nga dekani i fakultetit përkatës të UMT-së. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZS-së dhe KQV-së deklaron hapjen e votimit, por jo më vonë se ora 09:00.
2. Fletët e votimit janë të vulosura në pjesën e pasme, në vendin e caktuar, me vulën e KZS-së. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi zgjedhësi hyn në qendrën e votimit:
  - a) thotë emrin e tij dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identifikimit:
    - letërjoftim ID;
    - pasaportë.
  - b) kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
  - c) nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
  - d) kryetari vulos fletën e votimit me vulën e KZS-së/KQV-së dhe ia jep zgjedhësit.
  - e) pasi merr fletët e votimit, hyn në dhomën e fshehtë dhe në krah të emrit të kandidatit shënon



shenjën “X” ose “+”, ose çdo shenjë tjetër brenda kuadratit të përcaktuar për shënim nga ana e zgjedhësit.

f) pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletët në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.

3. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës.
4. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimit nga ana e votuesit.
5. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
  - a) anëtarët e KZS-ve ose KQV-ve dhe vëzhguesit e miratuar nga KIZS-ja për llogari të kandidatëve;
  - b) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre.

#### **Neni 24** **Mbyllja e votimit**

1. Qendrat e votimit mbylLEN në orën 15:00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit të të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin.
2. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumentit të identifikimit. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e komisionit.

#### **Neni 25** **Veprimet pas mbylljes së qendrës së votimit**

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari, në praninë e anëtarëve të komisionit kryen, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
  - a) shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, të cilët kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore.
  - b) iu deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të komisionit;
  - c) i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij.
2. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.





3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, i numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit numëron dhe fletët e papërdorura dhe i vendos ato në zarfin përkatës. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Kryetari i KQV-së, bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit, dorëzojnë në KZS-në e fakultetit përkatës kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të qendrës së votimit.
6. Procesi vijues i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e këshillit studentor të fakultetit kryhet nga KZS-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.

### **Neni 26**

#### **Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjet e këshillave studentorë të fakulteteve të UMT-së**

1. Procesi i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e këshillit studentor të fakultetit kryhet nga KZS-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.
2. Kryetari i KZS-së nxjerr nga kutia e votimit fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj, ai:
  - a) vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të KZS-së. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
  - b) numëron votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;
  - c) verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të gjenden në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të hartuar më parë të KQV-ve ose KZS-së përkatëse, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletëve të votimit të papërdorura dhe fletëve të votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal;
  - d) harton tabelën përfundimtare për kutinë përkatëse dhe e miraton me vendim.
3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
  - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KIZS;
  - b) fletës së votimit i mungon vulat;
  - c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
  - d) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të studentit kandidat;
  - e) është votuar në tejkallim të përcaktimeve në fletët e votimit;



- f) nuk është votuar për asnjë kandidat.
4. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZS-ja harton tabelën përfundimtare të rezultatit të votimit sipas numrit të votave.
  5. Tabela përfundimtare dhe vendimi përkatës i KZS-së, si edhe të gjitha procesverbalet e tjera nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe kryetari, duke deklaruar votën “pro” ose “kundër”.
  6. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të votimit u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.
  7. Çdo kontestim apo vërejtje e kandidatëve shënohet detyrimisht në procesverbal nga sekretari i KZS-së.
  8. Në përfundim të procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, në prani të KZS-së dhe/ose kandidatëve të pranishëm;
    - a) futen dhe administrohen në kutinë e votimit fletët e votimit të numëruara të vlefshme dhe të pavlefshme;
    - b) futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi ‘Fletëvotimi të papërdorura’;
    - c) futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi ‘Fletëvotimi të dëmtuara’
    - d) futet dhe administrohet në kutinë e materialeve zgjedhore procesverbali për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të papërdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara, si edhe tabela përfundimtare e rezultatit të votimit për KZS-në përkatëse.
  9. Kryetari i KZS-së mbyll kutitë e votimit dhe shënon në procesverbal elementet e sigurisë (kodet) për mbylljen e këtyre kutive.
  10. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit në KIZS bëhet nga kryetari i KZS-së, me procesverbal, në prani të anëtarëve të KZS-së përkatëse dhe/ose kandidatëve, menjëherë pas përfundimit të proceseve të përshkruara në këtë rregullore.

#### **Neni 27**

#### **Shpallja e rezultatit paraprak të zgjedhjeve për Këshillin Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

1. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, nxjerrjes së rezultatit të votimit nga gjithë KZS-të dhe dërgimit të tyre në KIZS, ky i fundit, brenda 24 orëve, harton tabelën e rezultateve të votimit dhe shpall, me vendim të veçantë, rezultatet e zgjedhjeve për anëtarët dhe kryetarin e këshillit studentor të fakultetit përkatës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
2. Tabela e rezultateve zgjedhore dhe vendimi i KIZS-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët.
3. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.



## **Neni 28**

### **Ankimimet**

1. Kundër vendimeve të KIZS-së për shpalljen e tabelave përfundimtare të rezulttit të zgjedhjeve, ankimimi bëhet nga kandidatët në KIZS jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e shpalljes së tyre. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas dy ditëve kalendarike. KIZS-ja administron dhe merr vendime për ankimimet jo më vonë se 48 orë pas paraqitjes së tyre.
2. Kundër vendimeve të KIZS-së për ankesat e kandidatëve për rezultatin e zgjedhjeve, apelimi i vendimit bëhet nga kandidatët në Komisionin e Apelimit Studentor (KAS) jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike.
3. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve të dërguara nga Komisioni i Apelimit Studentor, KIZS-ja shpall, me vendim të veçantë, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Data e thirrjes së mbledhjes së parë të këshillave studentorë të fakulteteve të UMT-së caktohet nga kryetari i zgjedhur i këshillit studentor të fakultetit. Kjo datë shënon edhe fillimin e punës së këshillit studentor të fakultetit.

## **Neni 29**


### **Zgjedhja e kryetarit të Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

1. Pas përfundimit të afateve të apelimit, organizohet mbledhja e parë e Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, e cila thërritet nga KIZS-ja jo më vonë se dy javë nga ky afat. Në këtë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët dhe kryetarët e këshillave studentorë të fakulteteve të UMT-së, të shpallur fitues nga zgjedhjet e zhvilluara. Në këtë mbledhje bëhet konstituimi dhe, më pas, caktohet data e mbledhjes së dytë në të cilën zgjidhet kryetari i KSUMT-së. Mbledhja e dytë drejtohet nga kryetarët e këshillave studentorë të fakulteteve të UMT-së. Në këtë mbledhje, ata, bashkë me të gjithë anëtarët e këshillave studentorë të fakulteteve të UMT-së, zgjedhin mes tyre me votim të fshehtë kryetarin e Këshillit Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i cili vetëkandidohet ose propozohet nga anëtarët dhe kryetarët e këshillave studentorë të fakulteteve të UMT-së. Mandati i kryetarit të KSUMT-së është 2-vjeçar.
2. Kryetari ose anëtari i këshillit studentor të fakultetit, i zgjedhur në postin e kryetarit të Këshillit Studentor të UMT-së, mban dhe postin e mëparshëm.

## **Neni 30**

### **Pavlefshmëria e zgjedhjeve**

1. KIZS-ja, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më



shumë qendra votimi, në rast se:


- a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
  - b) mund të jetë cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
  - c) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve kërkuesi duhet ta shoqërojë me shpjegimin për arsyet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën bëhet nga KIZS-ja, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendrike nga depozitimi i saj.

### **Neni 31** **Dispozita të fundit**

1. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivën e KSUMT-së, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
2. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit ose anëtarëve të KSUMT-së apo këshillave studentorë të fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, ata zëvendësohen nga kandidatët pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhje, deri në përfundim të mandatit të nisur.
3. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Komisioni Institucional Zgjedhor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i cili mund të ofrojë mbështetje përgjatë të gjithë procesit zgjedhor.
4. Të gjitha shpenzimet për procesin zgjedhor për Këshillin Studentor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, do të mbulohen nga fakultetet e UMT-së.
5. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha strukturat studentore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe hyn në fuqi menjëherë.

### **Neni 31/1**

1. Vendimet e Komisionit të Apelimit Studentor (KAS), të marra deri sot më 16.03.2018, mund të apelojnë nga vetë të interesuarit në Komisionin e Apelimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë brenda orës 16:00 të datës 19.03.2018. Vendimi do të merret brenda 24 orëve nga KA UMT dhe do të jetë i formës së prerë.
2. Procesi i votimit do të zhvillohet në prani të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve përkatëse të UMT-së.



3. Procesi i vlerësimit dhe numërimit të votave do të kryhet nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit (KZF) nën vëzhgimin e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Studentor (KZS) të fakultetit përkatës, kandidatëve për kryetar/anëtar të këshillit studentor të fakultetit si dhe vëzhguesve të tyre.
4. Ambjentet e KZS-ve të fakulteteve përkatëse të UMT-së në të cilat do të numërohen votat e studentëve do të regjistrohen audio dhe video me kamera sigurie.

Për përcaktimet e kësaj rregulloreje që bien ndesh me ato të Vendimit nr.20, datë 16.03.2018, të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, do të zbatohen këto të fundit.

### **KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**ARBEN GJATA**

